



TEKAINJECT W

lëng injektues hidroizolues

FUSHA E PËRDORIMIT

Hydroblocker Tekainject W është solucion transparent uhor i silikonateve dhe shtesave të veçanta i dedikuar për kryerjen e hidroizolimeve horizontale kapilare të mureve të lagështa me procedurë injektimi. Përdoret për hidroizolim e mureve të lagështa të vjetra (të ndërtruara më parë), në rastet kur në mure paraqitet ngritja kapilare e ujit.

VETITË THEMELORE

Vetitë	Vlerat e dekluarat
Dukja	Lëng i pangjyrë
Densiteti, 20°C	1,05 kg/dm ³
pH	13 ± 1

VEPRIMI DHE UDHËZIME PËR PËRDORIM

- Hydroblocker Tekainject W** për shkak të përmbajtjes së vetë me lehtësi absorbohet edhe në poret më të vogla kapilare të murit të cilin e sanojmë. Në atë reagon ashtu, që formon një shtresë materiali me veti hidrofobike, përkatësisht me reduktim të lartë të absorbimit kapilar të ujit. Në këtë mënyrë absorbimi i ujit, përkatësisht sasia e lagështisë në mur, zvogëlohet për rreth 70 - 90%.
- Koha e reagimit (veprimit) varet nga lloji i materialit të murit, lagështia relative, temperatura e mjedisit dhe sasia e CO₂ në ajër.
- Vrimat injektuese nëpër të cilat injektohet **Hydroblocker Tekainject W** duhet të lihen të hapura ca. 4 javë, dhe pastaj ato i mbushim me llaçin hidrofobik (llaç me shtesën mbyllëse Cementol Hidrofob E- shtesë për zvogëlimin e absorbimit kapilar të ujit në llaç).
- Kur muri afërsisht është terur, pjesët e lagështa dhe të shkrufta të llaçit, të cilat i kemi hequr para fillimit të sanimit, i zëvendësojmë me llaçin e ri hidrofobik të përgatitur me shtesën Cementola Hidrofob E.

Paralajmërim

- Hydroblocker Tekainject W** nuk është i përshtatshëm për hidroizolim e mureve tek te cilat llaçi lidhës ka akoma veti alkaline (muri i ri).
- Para fillimit të sanimit duhet të vendosni, nëse është e sigurt që shkaktari i dëmtimit është ngritja kapilare dhe përhapja kapilare, ose deri te lagështia vjen për shkaqe të tjera (puseta të dëmtuara, instalimet, drenazhimet, mbuluesit e çatisë, llaç i shkruftë-lirë dhe dëmtuar etj.).
- Procedura e sanimit duhet të kryhet nga ekip/punëtorë profesionalisht të aftë.

KONSUMI

Ca. 8 - 10 l/m për mur me trashësi 50 cm, varësisht nga lloji i porozitetit të materialit të murit (tulla, gur, lloje të tullave dhe gurëve, shkruftësia-fortësia e llaçi të murit etj.).

AMBALAZHIMI

- kanistër plastike 10 kg, fuçi 60 kg

MAGAZINIMI

- Produkti duhet të ruhet në ambalazh të mbyllur mirë, i mbrojtur nga dëmtimet, ngrirja dhe temperaturat e larta.
- Në ambalazh të padëmtuar dhe të mbyllur mirë, i ruajtur në temperaturë normale, afati i përdorimit është minimum 2 vite nga data e prodhimit.
- Pas skadimit të datës së përdorimit produkti nuk është domosdoshmërisht i papërdorshëm, veçse duhet të testohen ato veti të cilat janë të rëndësishme për përdorimin e caktuar.

PARALAJMËRIME SIGURIE

Hydroblocker Tekainject W, për shkak të alkanilitetit të lartë, është shumë irritues, dhe për këtë mund të shkaktojë plasaritje dhe dëmtime të membranave të mukozës (dëmtime në sy). Për këtë gjatë punimeve duhet të mbajmë veshjen adekuate mbrojtëse, dorezat mbrojtëse si dhe mbrojtëse për sy. Nëse vjen deri të spërkatja në lëkurë ose në sy, menjëherë duhet t'i shpërlajmë me sasi të madhe të ujit, veshjen e lagur e heqim dhe kërkojmë ndihmën mjekësore.

Gjatë punës me **Hydroblocker Tekainject W** duhet t'iu përmbahemi udhëzimeve të përgjithshme për përdorimin e kimikateve:

- gjatë punës nuk duhet ngrënë, pirë dhe pirë duhan;
- pas kryerjes së punimeve, duart i lajmë shumë mirë me ujë.

VËREJTJE

Udhëzimet janë dhënë në bazë të hulumtimeve dhe përvojës tonë, por për shkak të kushteve specifike dhe mënyrës së punimeve rekomandojmë testime paraprake për secilin rast të veçantë të përdorimit. Pasi që nuk mund të ndikojmë në kryerjen e punimeve, nuk mbajmë përgjegjësi për cilësinë e tyre!

PROCEDURA E INJEKTIMIT TË MUREVE ME LAGËSHTI KAPILARE ME HYDROBLOCKER TEKAINJECT W

1. Llaçi i vjetër, i lagësht duhet të hiqet së paku deri në lartësinë e ngritjes së lagështisë, dhe rekomandohet afërsisht 30 cm mbi kufirin e ngritjes së lagështisë.
2. Vrimat për injektim realizohen në dy rrede, në renditje "cik-cak", ashtu siç është parqitur në skica (shpimi i murit prej tulle dhe shpimi i murit prej guri).
 - Rendi i parë: min 15 cm mbi nivelin e terrenit
 - Largësia në mes të rendeve: ca. 10 cm.
 - Largësia në mes të vrimave në një rend :
 - ca. 15 cm (tullë poroze)
 - ca. 7,5 cm (Ilaç ndërmjet tullave poroze, gurit)
 - Diametri i vrimës: 25 - 30 mm
 - Këndi i shpimit: 30° - 40° ndaj anës së kundërt të murit
 - Thellësia e vrimës: fundi i vrimës 7 - 10 cm i larguar nga ana e kundërt e murit.
3. Nga vrima thithim ose fryejmë të gjithë pluhurin. **Hydroblocker Tekainject W** e injektojmë me rënie të lirë ose me shtypje të ulët aq gjatë, derisa muri ta absorbojë lëngun. Nëse injektohet me shtypje, kjo varet nga ajo nëse injektohen fugat (lidhjet) ose masa e murit (tulla, guri), si dhe nga poroziteti i tyre. Rënia e shtypjes do të thotë humbje e lëngut (plasaritje, fole etj.).
4. Sipërfaqet poroze dhe fugat (lidhjet) e zbrazëta nën dhe mbi zonën e injektimit i mbyllem me bazën lysterëse të papërshkueshme nga uji Hydroblocker Hidroizol N ose S, në mënyrë që të parandalohet rrjedhja e **Hydroblocker Tekainject W** nga muri.
5. Muret me trashësi më të madhe se 50 cm injektohen nga të dyja anët.
6. Pas ngopjes/njomjes së plotë të murit, vrimat i lëmë të hapura 4-6 javë, dhe pastaj i mbushim me Ilaçin hidrofobik (Ilaç me shtesa për zvogëlimin e absorbimit kapilar- mbyllësin Cementol Hidrofob E).
7. Pas terjes së murit, pjesët e shkruara dhe lagështia të Ilaçit i largojmë para fillimit të sanimit, i zëvendësojmë me Ilaç të ri hidrofobik që përmban shtesën Cementol Hidrofob E.